

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-129/12

**Prishtinë,
17 prill 2013**

Në çështjen juridike të:

Sh. Sh.

Pala ankuese

Kundër

P. T. D.

Paraqitësja e kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarja Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vepruar në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/100/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA34377) të datës 23 shkurt 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 17 prill 2013, lëshoi këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Anullohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/100/2011 i datës 23 shkurt 2011 për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA34377 dhe hedhet poshtë kërkesa pasi që lënda nuk është në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të KKPK-së.
- 2- Obligohet pala përgjegjëse në ankesë që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 45 (katër dhjetë e pesë) brenda afatit 90 (nëntëdhjetë) ditore nga data e dorëzimit të aktgjykimit ose përndryshe përmes ekzekutimit të detyrueshëm.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me datën 26 korrik 2007 P. T.D. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkonte vërtetimin e së drejtës së saj pronësore dhe ri-posedim të pronës e cila gjendej në Përlepticë, Gjilan, ngastra nr. 1350, kopsht i klasës së dytë me sipërfaqe prej 10 ari dhe 42 m². Ajo sqaronte se ai është pronar i kësaj ngastre dhe se ajo e kishte humbur atë më 28 korrik 1999 si rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë. Lënda ishte regjistruar në AKP me numrin KPA34377.

Paraqitësja e kërkesës ka dorëzuar në AKP Fletën Poseduese nr. 250 të datës 23 korrik 2002 e cila paraqiste se ngastra kontestuese ishte e regjistruar në emrin e T.Z.D., dhe certifikatën e vdekjes së këtij të fundit, nga kjo përcaktohet se paraqitësja e kërkesës ishte gruaja e tij.

Në vitin 2008 AKP ka bërë njoftimin në lidhje me kërkesën duke e vendosur një shenjë në vendin ku supozohej se ndodhej ngastra. Në vitin 2010, AKP përsëri ka njoftuar në lidhje me kërkesën, këtë herë duke e shpallur kërkesën në Gazetën Njoftuese nr. 3 dhe në Buletinin e Zyrës së Pronës të UNHCR-it. Gazeta dhe Lista i ishin lënë një pronari të një shitoreje në Përlepticë i cili kishte pranuar t'i vejë ato në dispozicion të palëve të interesuara. Publikimet e njëjta gjithashtu ishin lënë në hyrje dhe dalje të fshatit Përlepticë si dhe në disa zyra zyrtare në Gjilan.

Pasi që askush nuk ishte përgjigjur, kërkesa ishte trajtuar si e pa-kontestuar dhe KKPK me vendimin e vet KPCC/D/A/100/2011 të datës 23 shkurt 2011 kishte miratuar kërkesën, ku vendoste se paraqitësja e kërkesës kishte dëshmuar se mbajtësi i së drejtës pronësore T.Z.D. ishte pronar i ngastrës.

Me datën 19 gusht 2011 vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar paraqitëses së kërkesës.

Me datën 18 tetor 2012, Sh. Sh. (nga tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur një ankesë në AKP, ku theksonte se ai i kishte blerë ngastrat 1350 dhe 1351 (ngastrat e kërkuara) të ndodhura në Përlepnice në vitin 1980 nga fqinji i tij serb D.T. (*sipas të gjitha gjasave T. ishte pseudonimi i T.*). Ai sqaronte se në praninë e dëshmitarëve A. Sh. dhe O. Sh. ai i kishte paguar D. T.– xhaxhait të paraqitëses së kërkesës shumën prej 15.000,00 Dinarë.

Gjithashtu, ai theksonte se në të njëjtën kohë ata kishin lidhur një kontratë private e cila ishte nënshkruar nga ai, dy dëshmitarët dhe D.T.. Për më tepër, ai shpjegonte se kjo kontratë nuk ekzistonte më sepse e njëjta ishte djegur së bashku me shtëpinë gjatë kohës së luftës. Ai vazhdon duke shtuar gjithashtu se ngastrat: 1350 dhe 1351 (ngastrat e kërkuara) që nga viti 1980 ishin shfrytëzuar nga ai pa asnjë pengesë dhe se ai akoma është në posedim të tyre. Në fund, ai ka theksuar se vendimi i KKPK-së është i gabuar sepse vendimi është lëshuar mbi bazë të mungesës së dokumenteve dhe ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës të marr në konsideratë deklaratën e tij duke e trajtuar atë në formën e duhur.

Ai ka dorëzuar dokumentet nga padia e dorëzuar në Gjykatën Komunale në Gjilan me datën 18 tetor 2012, aero-inqizimin kadastral dhe deklaratën e datës 18 tetor 2012.

Ankesa i është dorëzuar vajzës së paraqitëses së kërkesës (nga tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë).

Më 20 shkurt 2013 gjykata ka lëshuar një urdhër për palën përgjegjëse në ankesë ku i kërkohet asaj të përgjigjet në pretendimet se prona ishte blerë nga pala ankuese në vitin 1980.

Urdhri i është dorëzuar paraqitëses së kërkesës me datën 13 mars 2013.

Pas kësaj, përmes zyrës së UNCHR-it në Beograd, gjykata ka marrë një kërkesë nga paraqitësja e kërkesës me pranimin se prona ishte shitur dhe se ajo dëshironte që rasti të mbyllej.

E njëjta ishte konfirmuar nga vajza e saj V. D. e cila më herët ishte autorizuar të përfaqësoj të emën e saj në procedurën e kthimit të pronës - autorizimi i përgjithshëm (autorizimi) i dhënë nga paraqitësja e kërkesës me datën 19 gusht 2011. Znj. D. e ka pranuar para Sekretarisë Ekzekutive se prona ishte shitur.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme edhe pse pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurën para KKPK-së. Kjo rrethanë nuk mund të shkojë në dëm të palës ankuese pasi që në të vërtetë ai nuk ka qenë si duhet i njoftuar në lidhje me kërkesën. Njoftimi është bërë përmes publikimit të kërkesës në Gazetën Njoftuese të AKP-së dhe në Buletinin e UNHCR-it. Kjo, megjithatë, përbën “përpjekjet e arsyeshme” për të njoftuar në lidhje me kërkesën siç parashihet me nenin 10.1 të rregullores vetëm në rastet e jashtëzakonshme. Një rast i tillë nuk mund të gjendet në këtë rast. Pasi që gjykata nuk mund të përjashtoj se pala ankuese nuk ka qenë në dijeni në lidhje me kërkesën, ai duhet të pranohet si palë në procedurë, ankesa e tij është e pranueshme.

Në përgjigjen e saj ndaj ankesës pala përgjegjëse në ankesë ka theksuar se prona ishte shitur, e njëjta gjë ishte konfirmuar edhe nga vajza e saj, e cila është përfaqësuesja e saj ligjore, e cila e ka pranuar se prona i është shitur palës ankuese.

Kjo deklaratë duhet të konsiderohet si tërheqje e kërkesës (neni 149 i Ligjit për Procedurën Kontestimore) e cila është e mundshme jo vetëm para KKPK-së por edhe në procedurën para Kolegjit të Apelit të AKP-së (neni 193 i Ligjit për Procedurën Kontestimore).

Pas tërheqjes së kërkesës, gjykata pa kryer ndonjë procedurë të mëtejme do të marrë një aktgjykim ku do ta refuzoj kërkesën të cilën paraqitësi e kërkesës e ka tërhequr. Kjo, megjithatë, ka si parakusht rregullin e përgjithshëm që lënda të jetë në kuadër të kompetencave të gjykatës. Mirëpo, lënda këtu nuk është në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të KKPK-së/Kolegjit të Apelit të AKP-së.

Edhe pse KKPK si një organ pothuaj gjyqësor duke vendosur mbi meritat e kërkesës tanimë ka pranuar kompetencën e saj në lidhje me të, gjykata sipas detyrës zyrtare vlerëson nëse lënda bie në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të saj (neni 195.1 b) i Ligjit për Procedurën Kontestimore).

Rrjedhimisht, vendimi i KKPK-së meqë është ankimuar është dashur të anulohet dhe kërkesa të hedhet poshtë (neni 11.4 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079), jo të refuzohet.

Sipas Nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës

jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat ndaj asaj prone për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.

Në këtë rast, megjithatë, pala përgjegjëse në ankesë e pranon se ngastra i ishte shitur palës përgjegjëse në kërkesë dhe nuk kontestohet se kjo kishte ndodhur shumë kohë para konfliktit të armatosur të viteve 1998/1999.

Prandaj, humbja e pronës nuk është e ndërlidhur me konfliktin e armatosur gjatë viteve 1998/1999 në Kosovë.

Rrjedhimisht është dashur të anulohet vendimi i KKKP-së në lidhje me kërkesën në fjalë dhe kjo kërkesë të hidhet poshtë pasi që është jashtë kompetencave të KKKP-së dhe gjykatës.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, Neni 8.4 i Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet për procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme ankimore:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit, pasi që vlera e pronës së kontestuar mund të llogaritet të jetë më e vogël se € 1,000 (10.21, 10.15 dhe 10.1 i UA 2008/2): € 15.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala përgjegjëse në ankesë e cila ka paraqitur kërkesën e papranueshme. Për më tepër, paraqitësja e kërkesës/pala përgjegjëse në ankesë ka qenë në dijeni për këtë por pavarësisht kësaj ajo kishte paraqitur kërkesën. Sipas nenit 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, kur një person me vendbanim jashtë vendit është i obliguar të paguaj një taksë, afati për pagesën e saj nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë dhe as më i gjatë se 90 ditë. Gjykata vendos se

afati në këtë rast është 90 (nëntëdhjetë) ditë. Neni 47.3 parashih që në rast se pala nuk paguan taksën brenda afatit, pala do të duhet të paguaj një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk e paguan taksën në afatin e dhënë, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it